



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 15.08.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës **07.08.2023**, të parashtruar nga operatori ekonomik Arhiko .ING SHPK, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “**Konkurs projektimi për Nderimin e QKMF Shtime**” me nr prokurimi 206-23-5282-2-2-3, **nxjerr:**

V E N D I M

1. **Refuzohet** kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik Arhiko .ING SHPK, e dt. 07.08.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Konkurs projektimi për Nderimin e QKMF Shtime**” me nr prokurimi 206-23-5282-2-2-3, kundër NJOFTIMI PËR REZULTATET E KONKURSIT TË PROJEKTIMIT - REZULTATET E VLERËSIMIT ARTISTIK të datës 02.08.2023 të publikuar në platformën elektronike.
2. **Vërtetohet** NJOFTIMI PËR REZULTATET E KONKURSIT TË PROJEKTIMIT i datës 02.08.2023;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit*;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net> .

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik Arhiko .ING SHPK, me date 07.08.2023 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “**Konkurs projektimi për Nderimin e QKMF Shtime**” me nr prokurimi 206-23-5282-2-2-3. Autoriteti Kontraktues, me datë 15.08.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues sipas OE ankues:

- Neni 1 i LPP:Qëllimi
- Neni 7 i LPP:Barazia në trajtim jo diskriminimi
- Neni 52 i LPP:Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës

- Neni 56 i LPP:Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave
- Neni 59 i LPP:Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
- Neni 60 i LPP:Kriteret për Dhënien e Kontratës
- Neni 65 i LPP:Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve
- Neni 80 i LPP:Përbërja dhe vendimet e juris.
- Rregullore nr.001/2022 për prokurimin publik- nenin 17.12
- Rregullore nr.001/2022 për prokurimin publik- 46(46.7)-Procedura Tenderuese Një-zarf dhe Dy-zarfa
- Rregullore nr.001/2022 për prokurimin publik- Neni 55Neni 55- Konkurs për Projektim- 55.14- Dosja e konkursit të projektimit. Dërgesa e dosjes së konkursit për projektim
- Rregullore nr.001/2022 për prokurimin publik- 55.18 Kriteret e dhënies për projektimin Ideor
- Rregullore nr.001/2022 për prokurimin publik- 55.26-Hapja dhe vleresimi i projekteve
- Udhëzues nr.001/2023 për prokurimin publik-9. Kriteret e dhënies së kontratës

Prendimet ankimore

Të nderuar ne me daten 02.08.2023 permes platformes elektronike e-prokurimi jemi njoftuar me njoftimin mbi vendimin e AK-se në vlerësimin e fazës së pare të projekteve në këtë procedure

Ne pas kërkesës për qasje në dokumentacionin e e ku na është lejuar qasja, kemi vërejtur se

Duke u bazuar ne detyren projektuese per Konkurs projektimi për Nderimin e QKMF Shtime nga Operatore Ekonomik që synonin pjesëmarrjen në këtë konkurs projektimi, AK-MINISTRIA E SHËNDETËSISË-kërkon që i gjithë projekti te hartohen duke u bazuar në harmoni me dokumentet dhe rregullativen ligjore, ku i gjithë projekti do të vlerësohen sipas nënkritereve të vendosura nga ana juaj, dhe duke u bazuar në ligjet, rregullat dhe udhëzuesit për prokurimin publik.

Pas qasjes që kishim ne kemi të pa qartë se si projekti ideor i shifres 3547-të jete vleresuar me 80.9111 pasi që tek nënkriteret-

Shifra 8485- eshte vleresuar 80.911 pike perderisa ky OE nuk ka ofruar zgjedhje per distancat, Ashensori nuk ka qasje ne katin perdese, ku pacientit i duhet te shkoj ne katin e dyte per te pasur qasje ne ashensor.

Nyjet sanitare mungojne ne ordinancat, ndersa ne laborator nuk ka hapësire për mirembajtje, tek hapësirat e edukimit mungojne tualetet, Si dhe bodrume nuk posedon, ne e kemi te paqart se si te vleresohet me pike 80.9111, ndersa ky projekt ka mungesa ne projekt ne pikat kryesore te funksionalitetit te objektit, ndersa shihet qartas qe ky OE nuk i eshte permbajtur detyres projektuese si e tille oferta eshte dashur te vleresohet me pike minimale dhe te eliminohet nga procedura.

Shifra A3P7 -Ne baze te ligjit te prokurimit publike -RREGULLORE Nr.001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK-Neni 55Neni 55- Konkurs për Projektim- 55.14- Dosja e konkursit të projektimit. Dërgesa e dosjes së konkursit për projektim Shkruhet qartas qe duhet te ofrohet nje numer anonim prej kater shifreave sipas zgjedhjes se pjesemarresit- Ndersa shifra ne fjale permban Shkronja dhe jo Shifra sipas REGULLORES. Si e tille oferta eshte dashur qe te eliminohet dhe jo vleresohet siq kenë vepruar ne kundershitim me kete rregullore.

Gjithashtu ne projekt mungojn ordinancat, strehat e emergjences nuk jane adekuate, tek labororet nuk ka hapësire per mirembajtje higjienike, mungon paradhoma tek sherbimet e diagnostikes, ska hapësire te mirembajtjes, Dy njësi te tualeteve pa hapësire per mirëmbajtje tek Sherbimet Stomatologjiike, Depo për Rekuizita dhe Inventar larg salles se takimeve, Mungon dhoma për IT, Tek sherbimi I mirembajtjes nuk ka banjo te perbashket por vetëm WC - dhoma per punetor Teknik, Tek Urgjenca nuk ka Garderobe dhe nuk ka tush. ndersa ky projekt ka mungesa ne projekt ne pikat kryesore te funksionalitetit te objektit, ndersa shihet qartas qe ky OE nuk i eshte permbajtur detyres projektuese si e tille oferta eshte dashur te vleresohet me pike minimale dhe te eliminohet nga procedura.

Shifra 0306- Dalja nga oborri i QKMF në sheshin kryesor Komunikim jo i favorshëm brenda ngastrës ne aspektin e lëvizjes së automjeteve, Mungon tualeti për handicap tek hapësirat për edukim dhe promovim shëndetsor, Pozicionim jo I mire i hapësirës për vendosjen e pacientëve pa jetë tek shërbimi i mirëmbajtjes ndersa ky projekt ka mungesa ne projekt ne pikat kryesore te funksionalitetit te objektit, ndersa shihet qartas qe ky OE nuk i eshte permbajtur detyres projektuese si e tille oferta eshte dashur te vleresohet me pike minimale dhe te eliminohet nga procedura.

Shifra 3005- Pozicionim jo I prshtatshëm I ashensoreve, Holli qëndror e ka tejkaluar sipërfaqen e kërkuar, Hapësira për dhënie e infuzioneve I ka dy shtretër nga tre të kërkuar, Mungojne pisoarët tek nyjet sanitare për paciente tek ordinancat, Dhoma e infermiereve nuk ka lidhje direkte me hollin, Barnatorja për shërbim të pacientëve nuk ka sportel, Organizim jo I prshtatshëm tek shërbimet e diagnostikes, Mungon garderoba tek shërbimet stomatologjike dhe nje pisoar, Dhoma për punëtorët teknik nuk ka banjo të perbashket, Hapësirat për deponim të mbetjeve medicinale, depo për bocat e gazit medicinal dhe hapësira për generatorin mobil nuk është e parapare fare, Dyert e vogla tek tualetet për hendikep, Nuk ka lidhje direkte përmes ashensorit nga urgjenca deri në diagnostike, Nuk është respektuar distance nga kufiri I parcelës, perkunder ketyre mungesa kaq te shumta si dhe mos permbajtes ky oe eshte kualifikuar dhe edhe vleresuar me 56.355, ndersa ky projekt ka mungesa ne projekt ne pikat kryesore te funksionalitetit te objektit, ndersa shihet qartas qe ky OE nuk i eshte permbajtur detyres projektuese si e tille oferta eshte dashur te vleresohet me pike minimale dhe te eliminohet nga procedura.

Shifra 1208- Ska pisuar tek nyjet sanitare për personel tek ordinancat, Tek Laboratori hapësira e punës për administrim të laboratorit nuk ka sporter, Tek Laboratori dhoma për takime nuk ka kuzhine çaji, Laboratori nuk ka pritore, Tek shërbimet Diagnostike-Rentgeni nuk ka paradhoma, Tek shërbimet Stomatologjike dhoma e mjekve nuk ka lidhje direkte me ordinancën, Dhoma për trajner nuk ka dritare, Tek Hapësirat për edukim tek tualetet e Stafit nuk ka pisuar dhe mungon nje tualet I Temrave poashtu organizimi eshte jo i prshtatshëm, Dyert e ashensoreve janë me të vogla se 1m, Ashensori tek Shërbimi I urgjencës i ngushtë, Dhoma e infermiereve pa lidhje direkte me hollin e urgjencës, Distancat nga kutiri I parces nuk janë 1H, perkunder ketyre mungesa kaq te shumta si dhe mos permbajtes ky oe eshte kualifikuar dhe edhe vleresuar me 55.44, ndersa ky projekt ka mungesa ne projekt ne pikat kryesore te funksionalitetit te objektit, ndersa shihet qartas qe ky OE nuk i eshte permbajtur detyres projektuese si e tille oferta eshte dashur te vleresohet me pike minimale dhe te eliminohet nga procedura.

Shifra 8719- Bodrumi nuk ka ndriçim Natyror, Nuk është marrë parasysh terreni - Prerjet dhe fasadat kanë terren të rrafshët me Përdheshën, Nuk janë të paraqitura sipërfaqet në Planimetri, Ka hapësira të cilat nuk janë kërkuar në detyrën projektuese sic janë Pediatri dhe Dermatologu, Mungojne paradhomat tek Ordinancat e perbashketa, Mungon Hapësira për dhënie e Infuzioneve, Nuk ka pisuar tek tualetet për meshkuj tek Ordinancat, Mungon Barnatorja për shërbime të pacientëve, Mungojne Ordinancat e Vaksinimit, Mungojne garderobat e personelit tek Laboratori, Mungon Hapësira e punës për analiza laboratorike dhe Hapësira për administrim të laboratorit, Tek shërbimet e Diagnostikes hapësirat janë të pa ndara, Mungon salla e hapur për vendosjen e karrigeve stomatologjike, Mungojne hume hapësira tek shërbimi I mirëmbajtjes (rreth 4 hapësira), Nuk janë të specifikuar materialet në prerje, Nuk është paraqitur kufiri I parcelës në situacion, Salla e urgjencës është përdorur is parahyrje për dhomën e triazhit. Perkunder ketyre mungesa kaq te shumta si dhe mos permbajtes ky oe eshte kualifikuar dhe edhe vleresuar me 50.319, ndersa ky projekt ka mungesa ne projekt ne pikat kryesore te funksionalitetit te objektit, ndersa shihet qartas qe ky OE nuk i eshte permbajtur detyres projektuese si e tille oferta eshte dashur te vleresohet me pike minimale dhe te eliminohet nga procedura.

Ne e kemi të pa qarte se si projektet të cilat kanë kaq shumë mungesa si dhe të cilat nuk kanë permbushur detyrën projektuese të vleresohen me pike me shumë sesa projekti ynë, pasi që i shihni edhe sqarimet e lartecaktuara atehere e shihni se vlerësimi i bërë është në anë të mirë.

-Projekti ynë është një projekt i cili ka përmbushur kriteret në dosjen e tenderit, si dhe zgjedhja që ne kemi ofruar është një zgjedhje e cila ka për qëllim: më së miri përdorimin e efikas të hapësirave ekzistuese dhe për adekuate për mjedisin, programi i cili është më ekonomik.

-Pasi që kjo është në kundërshtim me **-Rregulloren Nr.001/2022 Për Prokurimin publik- 55.18 Kriteret e dhënies për projektimin ideor ku shkruhet qartas që duhet të zbatohen kriteret për projektimin ideor.**

-Autoriteti Kontraktues në dosjen e tenderit ka cekur që pragu minimal 50 pikë për të kaluar në fazën e II-te (hapja e zarfeve). Këtu shihet qartas që operatori ekonomik është favorizuar automatikisht ndërsa neve na ka vlerësuar me pikët minimale për mos kalimin në fazën tjetër (hapjen e ofertës financiare).

-Vlerësimi i kësaj procedure shihet qartas që është bërë në kundërshtim me **Rregulloren Nr.001/2022 Për Prokurimin publik -Hapja dhe vlerësimi i projekteve 55.26-** pasi që kjo rregullore dhe nën specifikohet që vlerësimi është dashur të bëhet duke siguruar integriteti dhe paanësin e procedurës gjë e cila nuk ka ndodhur në këtë procedurë.

Ne në qasje kemi pranuar edhe raportin e vlerësimit të anetareve të projektit të cilën edhe do të bashkëngjitem ku shihet qartas që komisioni ka shkëlur deklaratën nën betim të nënshkruar nga ana e tyre pasi që i gjithë vlerësimi është kryer në favor të kompanisë me shifrën 8485.

ku ky favorizim është në kundërshtim me Rregullore Nr.001/2022 Për Prokurimin publik -Neni 46 Procedura Tenderuese Një-zarf dhe Dy-zarfa pika 46.7. ku shkruhet qartas qe secili anëtar i komisionit vlerësues vlerëson çdo propozim teknik veçmas.

Anetarët e komisionit që kanë vlerësuar këtë projekt mendojnë që nuk janë profesionist të kësaj lëmie siq e parashikon ligji ku shkruhet qartas që komisionin duhet të jetë profesional i kësaj lëmie, sepse i gjithë vlerësimi ka qenë jo i drejtë dhe jo siq keni vepruar ju si Autoritet Kontraktues ku anetarët përveq se nuk kanë përmbajtur ligjeve, rregullave, udhëzuesve, dosjes së tenderit janë të profesioneve tjera jo të kësaj lëmie (projekteve)që të vlerësojnë në mënyrë profesionale siq e kërkon edhe Neni 80 i LPP:Përbërja dhe vendimet e juris.

-Gjithashtu AK-ja nuk e ka plotësuar edhe nenin 7-të LPP-së, ku edhe pse jemi OE i përgjegjshëm dhe gjithashtu kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-se dhe njoftimit për kontratë nuk jemi rekomanduar për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7-të LPP-së e parashih qartas qe Autoriteti Kontraktues do ti trajtojë operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente, Poashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parashih që gjatë udhëheqjes së një aktiviteti të prokurimit të gjitha autoritet kontraktuese do të sigurojnë që (vi)që tenderi i zgjedhur të pëepuhtet me të gjitha aspektet përmbajtësore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse mirepo AK-ja nu ki është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore. Duke u bazuar në dëshmitë dhe argumentet që u cekën më lartë, kërkojmë nga ana juaj si autoritet kontraktues që të merr:

VENDIM

Aprovohet, si e bazuar kerkesa per rishqyrtim e kompanisë sonë

Anulohet, njoftimi mbi vendimin e AK-së për vlerësimin e fazes se pare te projekti de lenda të kthehet në Rivlerësim, dhe gjatë rivlerësimit, ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave të bëhet siq e parashikon ligji nga profesionist të kësaj lëmie dhe rivlerësimi të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe conform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

Dëmet materiale

Pa anashkaluar demet materiale, më shumë dëm po i bëhet konkurrencës së ndershme dhe të drejtë.

Pergjigjia e Autoritetit Kontraktues ne lidhje me pretendimin Ankimore

I kemi shqyrtuar pretendimet ankimore te Kërkesës tuaj për Rishqyrtim dhe i kundërshtojmë si te pa bazuara. Ju ne Kërkesën për Rishqyrtim nuk e keni cekur shifrën e projektit tuaj, por ne baze te qasjes ne dokumentacion, mund ta kuptojmë se projekti juaj eshte me shifrën 0507, i vlerësuar i 9-ti ne liste me 35.436 pike.

Kërkesa juaj për Rishqyrtim është e pa pranueshme, meqenëse mungojnë pretendimet për dy projektet qe janë poentuar para juve me pike, konkretisht për projektet me shifrat 1412 dhe 0605.

Sa i përket pretendimit qe komisioni ka shkëlur deklaraten nën betim të nënshkruar nga ana e tyre pasi që i gjithë vlerësimi është kryer në favor të kompanisë me shifrën 8485, ne si AK-MSh nuk pajtohemi me këtë pretendim dhe konsiderojmë se juria ka qene profesionale dhe ka vlerësuar drejte për ta zgjedhur projektin me te kompletuar ne mesin e 10 projekteve ne konkurrencë.

Projektet janë vlerësuar nga Juria Profesionale e caktuar me Vendim te ZKA-se, ne përputhje me nenin 80 te LPP-se. Juria ka qene ne përbërje prej tre inxhinierëve, dy (2) Arkitekt dhe një (1) inxh. e Ndërtimtarisë. Vlerësimin e projekteve e konsiderojmë si profesional dhe përzgjedhja e projekteve nga juria është mandatorë për AK-MSh.

Juria profesionale i ka potencuar mangësitë e secilit projekt kur e ka hartuar listën e përshkrimit te projekteve dhe ju si ankues jeni bazuar ne atë liste për ti kontestuar projektet tjera, por komisioni nuk i ka potencuar përparësitë (avantazhet) ne mes projekteve, ku projekti i përzgjedhur ne vendin e pare

me shifrën 8485, i ka plotësuar me se shumti nevojat e AK, me shume përparësi funksionale, estetike, materializimi, etj, ne raport me projektet tjera.

Sa i përket pretendimit se nuk është bere vlerësimi i drejte i projekteve dhe në kundërshtim me Rregulloren Nr.001/2022 Për Prokurimin publik, ky pretendim aspak nuk qëndron, është i pa argumentuar dhe mjaft i pa qartë.

Shume aspekte teknike te cekura ne kërkesën tuaj për rishqyrtim si mangësi e projekteve tjera, nuk janë obligim i kësaj faze te projektit ideor, por janë obligim i kompanisë fituese ne fazën e me vonshme te përgatitjes se projektit detaj.

Ua rikujtojmë disa nga defektet e projektit tuaj qe janë listuar nga komisioni, te cilat janë defekte esenciale dhe te pa tejkalueshme për këtë objekt:

- Trajtimi arkitektonik nuk është mbështetur as me të dhënat elementare në vizatimet teknike- NUK janë ofruar prerjet Karakteristike të ndërtesës
- Lëvizja e atumjeteve dhe këmbësorëve është e vështirësuar dhe e pakuptimtë në disa pika
- Hyrja e Autoambulacës është shumë e ngushtë dhe jo e përshtatshme për funksionin e destinuar
- Pjerrësitë e rampave ne përgjithësi janë shumë të mëdha
- Pozicionimi I casjes në bodrum është pengesë për lëvizjen e veturave tjera në oborr duke përfshirë edhe autoambulancën
- Ka 4 ashensorë gjithësejt (dy tepër)
- Ka pjesë ku muri interferon në Dritare
- Hyrjet kryesore kanë marrë trajtim sekondar në aspektin e pozicionimit
- Nuk janë prezantuar kthinat teknike për mbetje medicinale, gazra dhe gjenerator

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.


Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit